REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 139 /17
Datë/Datum. 31.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherit të Prokurimit: **"Agjencia Kadastrale e Kosovës".**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar BIBAJ - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Raporti lidhur me Ankesen nr. **139/17**, parashtruar nga OE , **„Geo – Map & Consult enginering"shpk, - Prishtinë**		
Datë:	**31.05.2017.**		

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "***Rindertimi i informacioneve kadastrale në 15 zona kadastrale, komunat Drenas, Skenderaj, Kamenice dhe Viti***", me nr. të Prokurimit: **60100/17/005/211**. të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "**Agjencia Kadastrale e Kosovës**", me përgjigjejet ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **„Geo – Map & Consult enginering"shpk, - Prishtinë,** me nr. **139/17,** të datës **12.05.2017.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues – teknik, lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.
Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - **"Agjencia Kadastrale e Kosovës".**
- Panelit Shqyrtues - "OSHP".
- OE - ankues - **„Geo – Map & Consult enginering"shpk, - Prishtinë**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		22.05.2017		24.05.2017		31.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **12.05.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **139/17**, e parashtruar nga OE NSH **„Geo – Map & Consult enginering"shpk, - Prishtinë**, kundër AK – **Agjencia Kadastrale e Kosovës**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "***Rindertimi i informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale, komunat Drenas,Skenderaj, Kamenice dhe Viti"***, me nr. të Prokurimit: **60100/17/005/211**.
Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Agjencia Kadastrale e Kosovës.**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues NSH **„Geo – Map & Consult enginering"shpk, - Prishtinë.**

Pikat e Ankesës nga OE NSH **„Geo – Map & Consult enginering"shpk, - Prishtinë**, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*
Neni 1, 56, 59, 62 dhe 72, te LPP-se.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Te nderuar, M date 28.04.2017 ne kemi bere kerkese per rishqyrtim pran AK , në.pergjigjien e dhene
ng I AK nuk kemi pranuar ndonje pergjigjie te qarte apo vendim ne lidhje me pranimin e ap refuzimin e kerkese per rishqyrtim po vetem disa spjegime ne lidhje me kerkesat tona
,AK ne.pergjigjigjiet e dhena nuk jan mirrur me pikat e ankeses por kan bere spiegime te pa iendrushme, ne mendojna se eshte nje shkelj.

Te nderuar kerkojme nga OSHP qe ta shqyrtoni drejte dhe ne menyre objektive kete Ankes, pasi q asnjera nga arsyet e eliminimit tone nuk eshte e qendrueshme.
letren standarde per tenderues te eliminuar AK ka cekur se nuk e kemi permbushur Ice: kesen ne lidhje me menaxherin e projektit dhe udheheqesin e projelctit ndersa ne pe. gjigjen e elt:25.04.2017 te dhene nga zyrtarja e AK na thuhet se jemi eliminuar per
fal tin se CV e dordzuara nuk i permbushin kerkesat per 3 anetare te stafit kyc profesional Si itë vijim:
Faton Bajselmani

Ferid Ahmeti
Fjc ha Zurnaxhiu

Prvete autoriteti kontraktues eshte treguar shume kunderthenes dhe subjektiv lidhur me arsyen tone te eliminimit.

Ne si konzorcium i plotesojme te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit e poashtu edhe per in hinieret e lartpermendur jane bashkangjitur deshmite si psh referencat, diplomat dhe CV. Prandaj arsyet e eliminimit tone jane te pabaza dhe subjektive duke mos u respektuar
ne: ii 59 i Ligjit per prokurim publik, pra ekzaminimi, vleresimi dhe lcrahasimi i ofertave nu ;. eshte bere sipas nenit te lartcekur.

Mt rastin e eliminimit tone nuk eshte respektuar edhe neni 56 i Ligjit per prokurim publik pa..agrafi 3 pasi qe aty thuhet qe asnje tenderues nuk mund te eliminohet per ndonje ke:kese ge nuk ehste e parashikuar ne dosje te tenderit dhe tek njoftimi per kontrate, ku se ne dosje te tenderit si deshmi e kerkuar dokumentare eshte kerkuar edhe CV e in) hiniereve kurse asnje fjale nuk eshte shenuar dhe sqaruar me teper se si duhet te jete CV e nje inxhinieri dhe se cka duhet te permbaje. Pra ne jemi eliminuar per kerkesa qe s'l and gene ne dosje te tenderit falctikisht ne nuk dime se cica nuk permbushin CV e in hiniereve tone. Keto arsye te eliminimit jane te pabazuara prandaj edhe jane shenuar
du x u perpjekur per te krijuar nje konfuzitet mirepo ketu s'mund te krijohet.konfuzitet pa: qe kerkesat jane te qarta dhe permbushja e ketyre kerkesave nga ana e konzorciumit
toi e jane te qarta. Autoriteti kontraktues ne kete rast nuk ka marr parasysh dhe i ka
dh në me shume peshe CV se sa referencave, e qe ne i kemi te gjitha. Edhe nese ev;ntualisht do te mungonte ndonje CV ose nuk do ti permbushte ndonje kusht atehere kjo do te konsiderohej nje devijim i vogel. Keshtu qe AK nuk e ka respektuar edhe nenin 1 te
Li; jit Per prokurim publik e ku thuhet qe : Qellimi i ketij ligji eshte te siguroj menyren me efil:ase, me transparente dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve publike, burimeve publike si dh,) te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove".

Dt ke na eliminuar neve ne menyre te kunderligjshme autoriteti kontraktues ka ardhur ne pe sfundim per te anuluar kete aktivitet te prokurimit ne menyre kunderligjore vetem per nil s te shpallemi ne fitues dhe me kete rast e ka cenuar dhe shkelur nenin 62 te Ligjit per

pr c kurim pubfik dhe nenin 44.7 te rregullave dhe udhezuesit operativ per prokurim pubfik

pa f i qe aty thuhet se nje nder arsyet e eliminimit eshte mungesa e ofertave te pet jegjshme, ndersa nes kete rast ne jemi te pergjegjshem.

Edhe nese AK 1;.a pasur ndonje paciartesi eventuale ne lidhje me cleshmite dhe dokumentet tor a atehere konform nenit 72 te Ligjit per prokurim publik ka mundur dhe eshte dashur tC na kerkon sqarime shtese pasi qe neni 72 lejon nje gje te tille por AK as qe e ka marr
mundin V vepron ne kete menyre (edhe pse gjithcka eshte ne rregull sa I perket dol.umenteve tona).

Kerkojme nga OSHP qe te shqyrtohet vedimi per anulim te ketij aktiviteti te prc kurimit nga AK cihe lenda te kthehet ne rivlersim dhe ne Si OE te shpallemi fitues.....

Demet material:

Demi material per kompanine vetem per pergatitjen e dosjes eshte ne vleren prej 2511.00 Euro dhe fitimi i realizuar pas perfundimit te kesaj kontrate.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	27.03.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	sherbimë/vlerë e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	12.04.2017
Data e hapjes së ofertave	12.04.2017
Data e njoftimit të anulimit në faqen e Krpp-së :	24.04.2017

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:: Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. duke përdorur formën në Aneksin 2	**Deshmia Dokumentare** Deklaratë nën betim -duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe i vulosur nga O. Ekonomik
Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.	Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore (nga vendi prej na vjen kompania) - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratësorigjinal/kopje
Vërtetimin nga Gjykata - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmërisë - te jete i lëshuar se paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit – origjinal/kopje e noterizuar.	
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	**Deshmia Dokumentare** Kopja e Certifikatës se regjistrimit të biznesit(nga vendi prej na vjen kompania)
Certifikata e regjistrimit të TVSH-së (nga vendi prej na vjen kompania)	Kopja e Certifikatës e TVSH-së (nga vendi prej na vjen kompania)
	Kopja e Certifikatës me numër fiskal (nga vendi prej na vjen kompania)
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: NA	**Deshmia Dokumentare NA** **Deshmia Dokumentare**

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Pjesëmarrja si kontraktor në së paku dy (2) kontrata brenda tre (3) viteve të fundit (2014, 2015 dhe 2016) me vlerë të barabartë me çmimin/ofertën e ofertuar nga ofertuesi, që është përfunduar me sukses dhe detajisht dhe që është e ngjashme (Rindërtim i Kadastrit) me punët e propozuara. Ngjashmëria do të bazohet në madhësinë fizike, kompleksitetin, metodën/teknologjinë apo në karakteristika të tjera	Listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare (2014,2015,2016), duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën, pranuesin si dhe 2(dy) Referenca apo raporte të pranimit të shërbimeve për realizimin me sukses, të barasvlershme me ofertën financiare të ofertuesit për këtë aktivitet të prokurimit.
Kompania duhet të dëshmoj se posedon pajisjet te listuara ne tabelen e meposhtme: Nr. Llojet e pajisjeve dhe karakteristikat Numri minimum i kërkuar **1** GPS-GNSS rover 5 **2** Stacion Total 5 **3** Softuer për përpunimin e të dhënave 1 **4** Kompjuter/llaptop 5 **5** Mjete transporti 5 **6** Fluturake pa pilot (dron) 1	Kompania duhet të ofrojë dëshmi mbi pronësinë; qiramarrjen apo kontratë për huazimin e pajisjeve
Ofertuesi duhet të deshmoj se do të ketë personelin për pozicionet kryesore që plotësojnë kërkesat e mëposhtme: Nr. Pozita Përvojë pune të ngjashme në total (vite) Përvojë pune të ngjashme (vite) 1 Menagjeri i projektit 10 8 2 Udhëheqësi i ekipit 5 3 Menaxheri i projektit Një (1) Menagjeri i projektit me dhjetë (10) vite eksperiencë në punët e një natyre ekuivalente dhe vëllimit, duke përfshirë jo më pak se tetë (8) vite si udhëheqësi i ekipit dhe të ketë së paku nivelin e shkollimit Master ose inxhinier i diplomuar nga fusha e Gjeodezi dhe Kadastër	Të dorëzohet CV-ja si dhe kopja e diplomës. Udhëheqësi i ekipit: Pesë (5) Udhëheqësa të ekipit me pesë (5) vite eksperiencë në punët e një natyre ekuivalente dhe vëllimit, duke përfshirë jo më pak se tre (3) vite si mbikqyrës dhe të ketë së paku nivelin e shkollimit Bachelor fusha e Gjeodezisë dhe Kadastrit. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Të dorëzohen CV-të si dhe kopje të diplomës.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"GAIA S.A MELETON..."	//////////////////	293 820.00 €	JO

2.	"LORENCO& CO & Urban Metropol"	Tirane	294 136.50 €	JO
3.	"Geo Map & Consulting enginering"shpk	Prishtinë	248 360.00 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 12.04.2017, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë tre (3) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Avni ahmeti
- - Anëtar i komisionit - Afrim Bajrami
- - Anëtar i komisionit – Leonora Sylejmani

Data e mbarimit të vlerësimit: 18.04.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....18.04.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

S'ka !

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues (N. 113, 114)

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi nr. 1 Autoriteti Kontraktues - "*Agjencia Kadastrale e Kosoves*", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është sherbim, kontratë publike me vlerë të madhe, operatori ekonomik ankues: NSH **„Geo – Map & Consult enginering"shpk,** - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, gjegjësisht kundër arsyetimit të eleminimit të potencuar në letër standarde të datës 24.04.2017, ku AK, tekstualisht ka cituar: *"Grupi i Operatoreve ekonomik NSH „Geo – Map prishtine & Consult enginering"shpk, Kaqanik, lidhur me personelin Udheheqesi i ekipit për 3 nga totali i kerkesave, CV-te e prezantuara /dorezuara nuk permushin kerkesat".*

Kundër të njejtit arsyetim parashtruesi i ankeses më datën 28.04.2017, paraqet kërkesë për ri-shqyrtim pran AK-së, me pretendimer ankimore se eleminimi gjegjësisht anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 1. 56, 59, 62, dhe 72 i LPP-së. Kundrejt të njejtës kërkesë AK, më datën 05.05.2017, jep përgjigje dhe refuzon si të pa bazuar kërkesën me arsyetimin se z. **Faton Bajselmani**, znj **Fjolla Zurgangjiu** dhe z. **Ferid Ahmeti**, sipas dëshmive dokumentare nuk plotesojnë kërkesën e AK-së.

Sqarimi nr. 2 Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë me kriterin e listuar në pikën **9.1 & 9.2**, të dosjes së tenderit *"kërkesat mbi mundesin teknike dhe / ose profesionale"*, ku AK, ka kërkuar një menagjer të projektit, *me dhjete (10) vite eksperienc pune të natyrës ekuivalente dhe vëllimit, duke përfshirë jo me pak se tetë (8) vite si udheheqës i ekipit ndërsa niveli i shkollimit master*

ose ingjinjer i diplomuar nga fusha gjeodezi dhe kataster, si dhe *pesë (5)* udhëheqës ekipi, *me pese (5) vite eksperience në punët e një natyre ekujvalente dhe vëllimit, duke përfshirë jo më pak se tre (3) vite si mbikqyrës, me kualifikim shkollore bachellor nga fusha e gjeodezisë dhe kadastrit*. Ndërsa si dëshmi dokumentare për të njëjtat kërkësa është kërkuar të dorezohen *CV-të si dhe kopjet e diplomave*.

Lidhur me atë që u tha më lartë sqarojmë se në shkresa të lëndës parashtruesi i ankesës posedon listen sipas përshkrimit, stafi kryesor i propozuar, dhe atë si më poshtë:

z. Ymer Kuka. Dr. I gjeodezise – Menagjer i projektit, sipas diplomes ingjinjer i gjeodezise.
z. Florent Emini ing (BSc) – udheheqes i ekipit
z. Faton Bajselmani ing (BSc) – udheheqes i ekipit
znj. Fjolla Zurnaxhiu, ing (BSc) – udheheqes i ekipit
z. Arbnor Zeqiri ing (BSc) – udheheqes i ekipit
z. Agron Shabani, ing (BSc) – udheheqes i ekipit dhe
z. Ferid Ahmeti, ing (BSc) – udheheqes i ekipit.

Ndërsa AK, sipas letrës standarde gjegjësisht sipas arsyetimit të vendimit kundrejt kërkesës për ri-shqyrtim potencon se z. Faton Bajselmani , znj. Fjolla Zurgagjiu dhe z. Ferid Ahmeti, sipas CV-ve, nuk e mbulojne dëshminë dokumentare mbi përvojën e punës.

Sipas shkresave të lëndes gjegjesisht sipas pershkrimit në kopjet e diplomave (të bashkangjitura në ofertë) rezulton që z. Faton Bajselmani, sipas përshkrimit ka diplomuar më datën 12 mars 2010, znj. Fjolla Zurgagjiu më datën 23 qershor 2011 dhe z. Ferid Ahmeti, me daten 23 gusht 2011, rrjedhimishte periudha kohore i përgjigjet kërkesës së AK-së (5 vite), ndërsa në CV-të, e të njejtëve te bashkangjituara në ofertë nuk përshkruhet nese të njejtit kanë qenë udhëheqës të ekipeve për projekte të caktuara. Megjithatë kopjet e referencave poashtu te bashkangjitura ne oferten e OE ankues, sipas pershkrimit rezulton që stati i kontestuar nga AK, kanë qenë pjes e projekteve të ndryshme, gjegjësisht referenca e dates 16 nentor 2015, nr ref: 17/15, referenca e dates 10 prill. 2017, me nr 03/17, dhe referenca sipas përshkrimit për z. Ferid Ahmetit, ku potencohet i njejti ka qenë pjesë e tri projekteve.

Andaj në mbështetje të asaj që u tha më lartë propozimi ynë për AK-n, është që sipas nenit 72, të LPP-së në fuqi të kërkohet nga parashtruesi i ankesës sqarim shtesë lidhur me stafin e prezantuar nga OE ankues, gjegjësisht të konkretizohen pozicionet e tyre sipas referencave të pershkruara më lartë, nëse përvoja e tyre i përgjigjet kërkesës së pikes 9.1, të FDT-së. Të njejtin propozim e mbështesim në nenin 39.8, të rregullave të UOPP-se ku përshkruhet menyra se si duhet të trajtohen problemin përmes tabeles, ku trajtohen situatat dhe rekomandimet se si të veprohet:

Problemi: - *CV-ja e dorezuar **nuk përmban informatat e kerkuara**, AK, nuk mund të vendos,*
Si të veprohet: - *Mund të kërkohen informata sqaruese*.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

Eksperti shqyrtues bazuar në sqarimet e cekura në raport i propozon panelit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit me titull: "Rindertimi i informacioneve kadastrale në 15 zona kadastrale, komunat Drenas, Skenderaj, Kamenice dhe Viti", me nr. të Prokurimit: **60100/17/005/211**, të **RI-VLERESOHET**, ndersa ankesa e OE **„Geo – Map & Consult enginering"shpk,** të aprovohet si e **bazuar pjesërisht.**